**LIGJ**
**Nr. 69/2016**

# PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË PËR BASHKËPUNIMIN FINANCIAR 2015, PËR PROJEKTIN "PROGRAMI PËR RINOVIMIN E KONVIKTEVE NË KAMPUSIN UNIVERSITAR TË TIRANËS, SIPAS PARIMIT TË EFICIENCËS ENERGJETIKE"

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1 dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin financiar 2015, për projektin "Programi për rinovimin e konvikteve në kampusin universitar të Tiranës, sipas parimit të eficiencës energjetike", sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 30.6.2016

**Shpallur me dekretin nr. 9683, datë 11.7.2016 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani**

## MARRËVESHJE

NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË PËR BASHKËPUNIM FINANCIAR 2015, PËR PROJEKTIN "PROGRAM PËR RINOVIMIN E KONVIKTEVE NË KAMPUSIN UNIVERSITAR TË TIRANËS, SIPAS PARIMIT TË EFICIENCËS ENERGJETIKE"

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë,

*në frymën* e marrëdhënieve ekzistuese miqësore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë;

*duke u nisur nga* dëshira për t'i forcuar dhe thelluar këto marrëdhënie miqësore nëpërmjet bashkëpunimit financiar si partnerë;

*të ndërgjegjshme se* ruajtja e këtyre marrëdhënieve përbën bazën e kësaj marrëveshjeje;

*me qëllim për të* kontribuar në zhvillimin social dhe ekonomik në Republikën e Shqipërisë;

*duke iu referuar* premtimit të Ambasadës së Republikës Federale të Gjermanisë (notë verbale nr. 102/2015, e datës 23 korrik 2015),

kanë rënë dakord si vijon:

Neni 1

1. Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë u jep mundësi Këshillit të Ministrave të

Republikës së Shqipërisë ose marrësve të tjerë, që do të zgjidhen bashkërisht nga të dyja qeveritë, të marrë nga Kreditanstalt für Wiederaufbau (KfW), një shumë financimi për zbatimin e projektit "Program për rinovimin e konvikteve në kampusin universitar të Tiranës, sipas parimit të eficiencës energjetike", me vleftë prej deri në 4 500 000 EUR (me fjalë: katër milionë e pesëqind mijë euro) kur nga shqyrtimi përkatës ka rezultuar se projekti vlen për t'u mbështetur në kuadër të politikës zhvillimore.

2. Po të bien dakord Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë, projekti i përmendur në paragrafin 1 mund të zëvendësohet me projekte të tjera.

3. Në rast se qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë në një kohë të mëvonshme i jep mundësi Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë të marrë nga Kreditanstalt für Wiederaufbau hua ose shuma të tjera financimi për përgatitjen ose për masa të nevojshme shoqëruese për zbatimin dhe mbikëqyrjen e projektit të përmendur në paragrafin 1, gjen zbatim kjo marrëveshje.

4. Shumat e financimit për masa përgatitore dhe shoqëruese do të kthehen në hua, në rast se ato nuk përdoren për masa të tilla.

Neni 2

1. Përdorimi i shumës së përmendur në nenin 1, kushtet me të cilat vihet në dispozicion ajo, si dhe procedura e dhënies së porosisë përcaktohen në kontratat që do të lidhen midis Kreditanstalt für Wiederaufbau dhe marrësve të shumave të financimit, të cilat u nënshtrohen dispozitave ligjore që janë në fuqi në Republikën Federale të Gjermanisë.

2. Premtimi i shumës së përmendur në nenin 1 do të zhvleftësohet, në rast se kontratat përkatëse për financim nuk lidhen brenda një afati prej shtatë vjetësh pas vitit të premtimit. Për shumat në fjalë, ky afat mbaron në datën 31 dhjetor 2022.

3. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, në rastet kur ai vetë nuk është marrësi i shumës së financimit, do të garantojë ndaj Kreditanstalt für Wiederaufbau pretendimet e mundshme për shlyerjen, që mund të lindin në bazë të kontratave për financim, të cilat do të lidhen sipas paragrafit 1.

Neni 3

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë e përjashton Kreditanstalt für Wiederaufbau nga të gjitha tatimet dhe taksat e tjera publike, që lindin në Republikën e Shqipërisë në kontekstin e lidhjes dhe zbatimit të kontratave, të përmendura në nenin 2, paragrafi 1.

Neni 4

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i lejon pasagjerët dhe furnizuesit të zgjidhin lirisht ndërmarrjet transportuese për transportimin e personave dhe të mallrave në rrugë detare, tokësore dhe ajrore, transport ky që rezulton nga dhënia e shumave të financimit, nuk merr asnjë masë, e cila përjashton ose vështirëson pjesëmarrjen me të drejta të barabarta të ndërmarrjeve transportuese me seli në Republikën Federale të Gjermanisë dhe, nxjerr sipas rastit, lejet e nevojshme për pjesëmarrjen e këtyre ndërmarrjeve transportuese.

Neni 5

Kjo marrëveshje hyn në fuqi në ditën kur Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i njofton qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, se janë përmbushur kushtet brenda-shtetërore për hyrjen në fuqi. Përcaktuese është dita e marrjes së njoftimit.

Bërë në Tiranë, më 19 prill 2016, në dy origjinale, secili në gjuhën shqipe dhe gjermane, duke pasur të dyja tekstet fuqi të barabartë.